RAPORTI I PERFORMANCËS PËR VITIN 2025

Bashkia Poliçan

PERFORMANCA 2026

Ky botim u mbështet nga 'Bashki të Forta', projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.

Asistenca teknike për përgatitjen e këtij botimi u ofrua nga Smart Processes, në kuadër të mbështetjes së projektit 'Bashki të Forta'.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

HELVETAS

Tabela e përmbajtjes.

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë 4

Kategoria: Shërbimet 5

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor 6

Arsimi i mesëm i përgjithshëm 12

Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit 16

Administrimi i pyjeve dhe kullotave 21

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile 24

Menaxhimi i mbetjeve 27

Përkujdesi Social 31

Strehimi social 35

Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime 37

Kategoria: Mirëqeverisja 40

Shërbimet Publike Vendore 41

Rrjeti rrugor rural 47

Planifikimi urban vendor 52

Policia bashkiake 54

Shërbimet e kujdesit parësor 56

Mbështetje për zhvillimin ekonomik 58

Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 61

Kategoria: Mirëqeverisja 64

Kategoria: Menaxhimi Financiar 65

Burimet Njerëzore 66

Të Ardhurat 67

Buxheti 69

Shpenzime 70

Vështrim i Përgjithshëm mbi Bashkinë



Bashkia e Policanit është një njësi administrative me rëndësi në Shqipëri, e vendosur në një zonë me histori të pasur industriale dhe kulturore. Tradicionalisht e njohur për sektorin e industrisë dhe metalurgjisë, bashkia po përballet me sfida të ndryshme në procesin e rindërtimit ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Ekonomia lokale po përpiqet të diversifikohet, duke nxitur sipërmarrjen lokale, zhvillimin e bujqësisë dhe sektorit të shërbimeve. Bashkia synon përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së jetës së banorëve përmes investimeve në arsim, shëndetësi dhe shërbime sociale. Gjithashtu, Policani ka potencial për zhvillim turistik dhe kulturor, duke shfrytëzuar trashëgiminë e tij historike dhe natyrore. Bashkia punon drejt një modeli zhvillimi që mbështetet në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike, komunitetit dhe sektorit privat, për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme dhe prosperuese.Bashkia Polican karakterizohet nga një ekonomi në tranzicion, e cila po përpiqet të kalojë nga një bazë industriale tradicionale drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm dhe të larmishëm ekonomik. Sektori i industrisë, i cili ka qenë historikisht motor i zhvillimit lokal, ka pësuar tkurrje, duke shtyrë bashkinë të kërkojë mundësi të reja zhvillimi në fusha të tjera. Në këtë kontekst, Bashkia Polican ka fokusuar përpjekjet e saj në nxitjen e sipërmarrjes lokale, mbështetjen e bujqësisë së qëndrueshme, dhe promovimin e sektorit të shërbimeve, veçanërisht atij turistik dhe kulturor. Investimet në infrastrukturë dhe përmirësimi i kushteve për bizneset synojnë të krijojnë një ambient më të favorshëm për zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të punës. Një rol kyç në strategjinë e zhvillimit ekonomik ka bashkëpunimi midis institucioneve publike, sektorit privat dhe komunitetit lokal, duke siguruar përfshirjen dhe përdorimin e efektshëm të burimeve për rritjen e mirëqenies së banorëve dhe zhvillimin afatgjatë të bashkisë.

Kategoria: Shërbimet

Monitorimi i performancës së shërbimeve është një funksion thelbësor për të siguruar cilësinë, qasjen dhe efektivitetin e shërbimeve që ofrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ky proces ndihmon në vlerësimin e mënyrës se si bashkia përmbush përgjegjësitë e saj ndaj qytetarëve, duke u bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Përpara shfaqjes së treguesve të një raporti performance, është e rëndësishme të theksohet se monitorimi i shërbimeve nuk kufizohet vetëm në matjen e rezultateve, por përfshin edhe analizën e burimeve të përdorura, procedurave të ndjekura dhe ndikimit real që shërbimet kanë tek komuniteti.

Kjo kategori mbulon disa fusha të rëndësishme të ofrimit të shërbimeve vendore, të cilat lidhen me cilësinë, efikasitetin dhe kënaqësinë e qytetarëve. Vlerësimi i tyre mundëson identifikimin e pikave të forta, sfidave dhe hapësirave për përmirësim në menaxhimin e shërbimeve publike.

Treguesit që përfshihen në këtë kategori do të ndihmojnë në kuptimin e performancës së bashkive në ofrimin e shërbimeve dhe do të shërbejnë si bazë për vendimmarrje më të informuar dhe orientim drejt rezultateve më të mira për qytetarët.

Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor



Numri i shkollave të arsimit nëntëvjeçar në bashkinë Poliçan është 16, nga ku :

- *Në njësinë administrative Poliçan janë 2*
- *Në njësinë administrative Vërtop janë 8*
- *Në njësinë administrative Tërpan janë 6*

Numri i kopshteve në bashkinë Poliçan është 10, nga ku :

- *Në njësinë administrative Poliçan janë 2*
- *Në njësinë administrative Vërtop janë 7*
- *Në njësinë administrative Tërpan janë 1*

Në arsimin parashkollor, Bashkia Poliçan ka regjistruar 95 fëmijë, të barabartë me numrin e fëmijëve rezidentë të moshës 3–6 vjeç në territorin e bashkisë, duke ruajtur mbulimin e plotë të kësaj grupmoshe. Numri i vajzave të regjistruara është rritur nga 46 në 52, ndërsa numri i djemve të regjistruar ka rënë nga 58 në 43.

Në arsimin bazë 9-vjeçar, numri total i nxënësve ka rënë nga 535 në 2024 në 485 në 2025, çka reflekton tkurrjen demografike të grupmoshës shkollore. Paralelisht, numri i mësuesve në arsimin bazë është ulur nga 81 në 73, ndërsa numri i klasave nga 51 në 47.

Në aspektin organizativ dhe të qeverisjes së shërbimit parashkollor, në vitin 2025 raportohen 7 kopshte me bord kopshti dhe 7 kopshte me këshill prindërish, ndërsa sistemi ka 18 edukatorë të trajnuar dhe 14 edukatorë të kualifikuar. Këto të dhëna tregojnë për përpjekje në drejtim të forcimit të menaxhimit të brendshëm dhe përfshirjes së prindërve në institucionet parashkollore.

Treguesit e shërbimit

Më poshtë ofrohet një pasqyrë e plotë mbi treguesit e performancës të lidhur me shërbimin e arsimit bazw pwrfshirw atw parashkollor.


Treguesi	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Përmirësimi financimit të institucioneve të arsimit parashkollor dhe bazë	Raporti i shpenzimeve (në lekë) në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Lekë/institucion)	1,179,346.15	1,334,346.15	1,797,576.92	1,746,489.42	2,222,754.81	**2,108,010.50**

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Përmirësimi financimit të institucioneve të arsimit parashkollor dhe bazë

- *Njësia matëse: Raporti i shpenzimeve (në lekë) në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të arsimit bazë dhe parashkollor (Lekë/institucion)*

Në vitin 2025, ky tregues arrin në 2,108,010.50 lekë për institucion, nga 2,222,754.81 lekë për institucion në vitin 2024. Pavarësisht uljes së lehtë të shpenzimeve totale nga 57.8 milionë lekë në 2024 në 54.8 milionë lekë në 2025, burimet financiare për institucion kanë siguruar qendrueshmëri të funksionimit të godinave të arsimit bazw pwrfshirw atw parashkollor.



Përmirësimi i standartit te mësimdhënies n% kopshte

Njësia matëse: Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor kundrejt numrit tw Edukatoreve të kualifikuara qw shwrbejnw nw arsimin parashkollor

Mesatarisht një edukatore mëson shtatë fëmijë në arsimin parashkollor. Mësimi në arsimin parashkollor në Bashkinë Polican bëhet sipas standartit të pë rcaktuar nga Ministria e Arsimit. Shifra në rënie e numrit të fëmijë , mund të kërkojë uljen e numrit të mësueseve të arsimit parashkollor, pasi ky tregues mund të shkojë në ulje në vitet e ardhshme, për arsye të uljes së numrit të fëmijëve në kopshte.

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Numri i fëmijëve vajza të regjistruara në sistemin parashkollor	numër				55	46	52
Numri i fëmijëve të moshës 3 - 6 vjeç rezident në territorin e bashkisë	numër				124	104	95
Numri total i godinave të kopshteve	numër		9	9	9	9	8
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç Meshkuj	numër				76	58	43
Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç Meshkuj	numër						13
Numri i fëmijëve në moshën 3-6 vjeç Femra	numër						52

Numri i fëmijëve në moshën 5-6 vjeç	numër						13
Numri i fëmijëve djem të regjistruar në sistemin parashkollor	numër				51	58	43
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor	numër		22		21	18	18
Klasa në sistemin parashkollor	numër		13			9	9
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	numër		157		106	104	95
Ndërtesa funksionale të arsimit bazë dhe parashkollor	numër						4
Numri i fëmijëve vajza të moshës 3 - 6 vjeç rezidente në territorin e bashkisë	numër				51	46	52
Nxënëse femra të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	numër		367	337	293	255	245
Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar	numër		747	732	609	535	485
Nxënës në sistemin arsimor bazë (arsimi 9 vjeçar) Meshkuj	numër		380	337	316	280	244
Numri i mësuesve në sistemin e arsimit bazë	numër		66	105	92	81	73
Klasa në sistemin e arsimit bazë	numër		62	60	57	51	47
Total shpenzime në arsimin parashkollor dhe bazë	lekë	30663 000	34693 000	46737 000	45408 725	57791 625	54808 273
Numri i kopshteve ku është ngritur bordi i kopshtit	numër						7
Numri i kopshteve ku është ngritur këshilli i prindërve	numër						7
Edukatorë të kualifikuar	numër						14
Edukatorë të trajnuar							18

Më poshtë paraqiten analiza e të dhënave historike pwr kwtw shwrbim.


- *Numri i mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor*

Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka ruajtur të pandryshuar numrin e mësuesve në sistemin e arsimit parashkollor, me 18 mësues, në të njëjtin nivel me vitin 2024. Pavarësisht se treguesi paraqet rënie krahasuar me vitet e mëparshme, stabilizimi i numrit të mësuesve në vitin 2025 tregon për ruajtjen e kapaciteteve bazë pedagogjike në shërbimin parashkollor.




- *Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor*

Për arsimin parashkollor, numri i fëmijëve të regjistruar ka qenë 157 fëmijë në vitin 2021, ndërsa në vitin 2023 ka zbritur në 106 fëmijë. Në vitin 2024 numri ka mbetur pothuajse i qëndrueshëm, me 104 fëmijë, por në vitin 2025 ka rënë më tej në 95 fëmijë. Krahasuar me vitin 2024, në vitin 2025 janë regjistruar 9 fëmijë më pak, ose rreth 8.7% ulje. Krahasuar me vitin 2021, ulja është më e ndjeshme, me 62 fëmijë më pak, ose rreth 39.5%.



Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjeçar

Për arsimin 9-vjeçar, numri i nxënësve të regjistruar ka rënë në mënyrë të vazhdueshme: nga 747 nxënës në vitin 2021, në 732 nxënës në vitin 2022, 609 nxënës në vitin 2023, 535 nxënës në vitin 2024 dhe 485 nxënës në vitin 2025. Vetëm gjatë vitit 2025, krahasuar me vitin 2024, numri i nxënësve është ulur me 50 nxënës, ose rreth 9.3%. Krahasuar me vitin 2021, rënia është 262 nxënës, ose rreth 35.1%.




Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Numri i shkollave të arsimit të mesëm të lartë në bashkinë Poliçan është 2, nga ku :

- Një është në njësinë administrative Poliçan, shkolla e mesme e përgjithshme “Muhamet Kondi”
- Një është në njësinë administrative Vërtop (fshati Mbrakull), shkolla e mesme e bashkuar

Në vitin 2025, Bashkia Poliçan paraqet përmirësim në të dy treguesit e analizuar. Raporti nxënës për punonjës mësimor është rritur nga 24 në 26, duke treguar përdorim më të lartë të kapaciteteve mësimore. Njëkohësisht, shpenzimi mesatar për nxënës është rritur ndjeshëm, me 39.0% krahasuar me vitin 2024, duke reflektuar rritje të mbështetjes financiare për arsimin e mesëm.



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025
Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar	Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor	34	34	28	24	**26**
Rritja e efiçencës buxhetore për përmirësimin e shërbimit arsimor të mesëm	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit të mesëm të përgjithshëm kundrejt numrit total të nxenesve te arsimit të mesëm të	6,501	43,023	17,288	16,416	**22,817**


	përgjithshëm (leke/nxenes)					

Më poshtë paraqiten analiza e të dhënave historike pë r këtë shërbim.


- *Mësimi në klasat e arsimit të mesëm zhvillohet sipas standardit kombëtar*

Numri mesatar i nxënësve për çdo punonjës mësimor

Në vitin 2025, ky tregues është 26 nxënës për punonjës mësimor, nga 24 nxënës për punonjës mësimor në vitin 2024. Kjo tregon një rritje me 2 nxënës për mësues, ose rreth 8.3% krahasuar me vitin paraardhës. Rritja e këtij raporti tregon një përdorim më të lartë të kapaciteteve mësimore në arsimin e mesëm, pasi i njëjti kapacitet pedagogjik mbulon një numër më të madh nxënësish. Megjithatë, treguesi mbetet më i ulët se nivelet e viteve 2021–2022, kur raporti ishte 34 nxënës për punonjës mësimor, çka reflekton ndryshimet në numrin e nxënësve dhe/ose të personelit mësimor gjatë periudhës.



- *Rritja e efiçencës buxhetore për përmirësimin e shërbimit arsimor të mesëm*



Në vitin 2025, shpenzimi mesatar për nxënës në arsimin e mesëm është 22,817 lekë/nxënës, nga 16,416 lekë/nxënës në vitin 2024. Kjo përbën një rritje prej 6,401 lekë për nxënës. Rritja e financimit për nxënës tregon një përmirësim të mbështetjes buxhetore për shërbimin e arsimit të mesëm gjatë vitit 2025.

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Total shpenzime për institucionin e arsimit të mesëm	lekë	4456000	4856000	29428000	9266343	7584049	9446033	
Nxënëse femra të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm	numër		103		248	232	210	
Numri i nxënësve që përfundojnë sistemin e arsimit bazë (9 vjeçar)	numër		110		103	96	97	
Staf mbështetës në sistemin e arsimit të mesëm	numër		11	12	13	14	15	
Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm	numër		747	684	536	462	414	
Nxënës të regjistruar në sistemin e mesëm arsimor (viti 10-12) Meshkuj	numër		126		217	88	74	
Mësues në sistemin e arsimit të mesëm	numër		22	20	19	19	16	
Klasa në sistemin e arsimit të mesëm	numër		11	11	11	10	8	

Objekte te arsimit të mesëm të përmirësuara / mirëmbajtura në vit	numër		1	1	0	1	0	

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm*

Në vitin 2025, Bashkia Poliçan ka pasur 414 nxënës të regjistruar në sistemin e arsimit të mesëm, nga 462 nxënës në vitin 2024 dhe 414 në vitin 2025. Kjo tregon një rënie të mëtejshme të frekuentimit në arsimin e mesëm. Ecuria shumëvjeçare tregon një tkurrje të ndjeshme të popullsisë shkollore në arsimin e mesëm, çka duhet të merret në konsideratë në planifikimin e rrjetit arsimor, burimeve njerëzore, kapaciteteve mësimore dhe buxhetimit të shërbimit.



Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit

Në vitin 2025, Bashkia Poliçan ka shënuar rezultate pozitive në shërbimin e ujitjes dhe kullimit. Treguesi i pastrimit të rrjetit ujitës ka arritur në 75%, nga 66% në vitin 2024, ndërsa treguesi i pastrimit të rrjetit kullues është rritur në 56%, nga 51% një vit më parë. Këto rezultate tregojnë përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës mbështetëse për bujqësinë dhe rritje të vëmendjes ndaj mirëmbajtjes së kanaleve vaditëse dhe kulluese. Ruajtja e nivelit 52% të tokës bujqësore të kultivuar tregon stabilitet të aktivitetit bujqësor, ndërsa përmirësimi i rrjeteve krijon mundësi për rritje të mëtejshme të prodhimit bujqësor në të ardhmen.



Sipërfaqja e tokës bujqësore nën ujë në :

- Njësinë administrative Poliçan është 0 ha
- Njësinë administrative Vërtop është 382 ha

Sipërfaqja e tokës bujqësore nën ujë në :

- Njësinë administrative Poliçan është 0 ha
- Njësinë administrative Vërtop është 382 ha

Njësinë administrative Tërpan është 84 ha Njësinë administrative Tërpan është 84 ha

Treguesit e shërbimit


Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025
Përmirësimi i rrjetit ujitës	Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)	6%	28%	38%	66%	75%
Përmirësim i rrjetit kullues	Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)	28%	38%	47%	51%	56%
Kultivimi i tokës bujqësore	Raporti në % i sipërfaqes bujqësore të kultivuar ndaj sipërfaqes totale bujqësore	52%	52%	52%	52%	52%

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Përmirësimi i rrjetit ujitës

Km kanal vaditës të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve ujitëse në pronësi të bashkisë (në %)




Përmirësim i rrjetit kullues

Km kanal kullues të pastruar kundrejt rrjetit total të kanaleve kulluese në pronësi të bashkisë (në %)

Të dhënat tregojnë progres të ndjeshëm në pastrimin e kanaleve kulluese në bashkinë Poliçan nga viti 2020 deri në 2025. Në vitin 2020, përqindja e kanaleve kulluese të pastruara ishte në nivelin më të ulët prej 0%, që tregon një mungesë evidente të veprimeve në këtë fushë. Pas një viti, në 2021, përqindja u rrit ndjeshëm në 28.2%, duke treguar përparim në përpjekjet për mirëmbajtje. Në 2022, përqindja arriti në 37.59%, çka pasqyron një vazhdimësi të masave për përmirësimin e rrjetit kullues. Deri në 2023, kjo përqindje vazhdoi të rritet duke arritur 46.99%, duke dëshmuar angazhimin e bashkisë në këtë drejtim.

Projekti shfaqi një planifikim afatgjatë, ku në 2024 përqindja e kanaleve të pastruara pritet të arrijë në 50.75%. Për vitin 2025, përqindja arrin në 56%, duke treguar një përkushtim të vazhdueshëm për përmirësimin e infrastrukturës së kullimit. Ky trend pozitiv është një tregues i rëndësishëm i angazhimit të bashkisë Poliçan për të administruar më mirë resurset ujore dhe për të përmirësuar mjedisin urban dhe agrar. Përmirësimet e tjera mund të synojnë arritjen e një rrjeti 100% të pastruar në të ardhmen. Komuniteti mund të përfitojë nga ky përparim përmes përmirësimit të kushteve të jetesës dhe rritjes së prodhimtarisë së tokave bujqësore.



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Shpenzime për pastrim dhe mirëmbajtjen e sistemit ujitës dhe kullues në lekë	lekë		460000			2374478	1872000	
Rrjet ujitës në pronësi të bashkisë në total në km	km		53.3	53.3	53.3	53.3	53.3	53.3
Rrjet kullues në pronësi të bashkisë në total në km	km		53.2	53.2	53.2	53.2	53.2	53.3
Numri i stafit i angazhuar pr sherbimin	numër		4	5	7	8	7	7
Sipërfaqja e tokës bujqësore (në ha)	ha		8878	8878	8878	8878	8878	8878
Sipërfaqe e tokës bujqësore e kultivuar (në ha)	ha		4658	4658	4658	4658	4658	5600

Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem ujitës (në ha)	ha		460	510	590	590	610	700
Sipërfaqe e tokës bujqësore e mbuluar me sistem kullues (në ha)	ha		440	440	400	400	435	650
Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km	km		15	20	25	27	30	40
Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km	km		3.1	15	20	35	40	40
Numri i familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi i ujitjes dhe kullimit	numër		1070	1170	1190	1190	1190	1190

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.


- *Rrjet kullues i mirëmbajtur/pastruar në km*

Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka përmirësuar treguesin e mirëmbajtjes dhe pastrimit të rrjetit kullues. Gjatë këtij viti janë mirëmbajtur/pastruar 30 km rrjet kullues, krahasuar me 27 km në vitin 2024. Rritja me 3 km tregon zgjerim të ndërhyrjeve në infrastrukturën kulluese dhe përmirësim të kujdesit për funksionimin e saj. Ecuria shumëvjeçare është pozitive, pasi volumi i rrjetit të mirëmbajtur është rritur në mënyrë të vazhdueshme nga 15 km në 2021 në 30 km në 2025.




Rrjet ujitës i mirëmbajtur/pastruar në km

Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka përmirësuar treguesin e mirëmbajtjes dhe pastrimit të rrjetit ujitës. Gjatë këtij viti janë mirëmbajtur/pastruar 40 km rrjet ujitës, krahasuar me 35 km në vitin 2024. Rritja me 5 km tregon zgjerim të ndërhyrjeve në infrastrukturën ujitëse dhe rritje të vëmendjes ndaj mbështetjes së zonave bujqësore. Ecuria shumëvjeçare është qartësisht pozitive, pasi rrjeti ujitës i mirëmbajtur/pastruar është rritur nga 3.1 km në vitin 2021 në 40 km në vitin 2025.



Numri I familjeve fermere që përfitojnë nga shërbimi I ujitjes dhe kullimit

Në vitin **2025**, Bashkia **Poliçan** ka ruajtur të njëjtin nivel të treguesit si në vitet 2023 dhe 2024, me vlerën **1,190**. Kjo tregon **stabilitet të performancës**, por jo rritje të mëtejshme krahasuar me vitin paraardhës. Ecuria shumëvjeçare është pozitive, pasi treguesi është rritur nga **1,070 në vitin 2021** në **1,190 në vitin 2025**, duke reflektuar një përmirësim të përgjithshëm prej **120 njësish**, ose rreth **11.2%** gjatë periudhës 2021–2025.



Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Pas zbatimit të Reformës Administrative-Territoriale, bashkive në Shqipëri iu ngarkua përgjegjësia për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura. Ky ndryshim synon forcimin e rolit të qeverisjes vendore në menaxhimin e burimeve natyrore, rritjen e përgjegjshmërisë, si dhe afrim më të madh të shërbimeve pranë komuniteteve. Përmes këtij procesi, bashkitë marrin një rol të drejtpërdrejtë në ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe zhvillimin e këtyre pasurive natyrore, duke ndikuar pozitivisht në mirëqenien ekonomike dhe sociale të banorëve. Bashkia është përgjegjëse për sigurimin e administrimit e shërbimeve pyjore, administrimin e fondit pyjor dhe kullosor, shfrytëzimin e racionalizuar të rezervave pyjore dhe kullosore, konservimin dhe zgjerimin e tyre. Bashkia siguron mikëqyrjen dhe disiplinimin e operacioneve pyjore, dhënien e liçencave për prerje pemësh, ripyllëzime, kontrolle të dëmtuesve dhe sëmundjeve si dhe ofrimin e shërbimeve për operatorët pyjorë.

Sipërfaqja e përgjihshme e fondit pyjor është *13,155.5* ***ha***

Në përbërje të fondit pyjor janë :

- *Sipërfaqe pyjore 9903.2 ha*
- *Sipërfaqe me bimësi pyjore 348.3 ha*
- *Sipërfaqe kullotë 1814 ha*
- *Sipërfaqe inproduktive 1090 ha*

Në përbërje të pyjeve janë :

- *Trungishte (pyje të lartë) 1545 ha*
- *Cungishte (pyje të mesëm) 1987 ha*
- *Shkurre (pyje të ulët) 6371.2 ha*



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


Treguesi	Përshkrim	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Rritja e efiçencës buxhetore për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor	Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)		215.05	395.36	523.66	523.68	562.80

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Rritja e efiçencës buxhetore për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor

Shpenzime për shërbimin e menaxhimit të fondit kundrejt sipërfaqes totale të fondit (Lekë për 1 ha pyje dhe kullota)

Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka përmirësuar treguesin e efiçencës buxhetore për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor. Treguesi është rritur nga 523.68 në vitin 2024 në 562.80 në vitin 2025, duke reflektuar një përdorim më të mirë të burimeve financiare në raport me menaxhimin e fondit pyjor dhe kullosor. Ecuria shumëvjeçare tregon përmirësim të vazhdueshëm, pasi treguesi është rritur nga 215.05 në vitin 2021 në 562.80 në vitin 2025.



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor (në ha)	ha		13155	13155	13155	13155	13155
Sipërfaqe totale e fondit pyjor (në ha)	ha		9903	9903	9903	9903	9903
Sipërfaqe totale e fondit kullosor (në ha)	ha		1814	1814	1814	1814	1814
Shpenzime per menaxhimin e fondit pyjor në lekë	lekë	2979000	2829000	5201000	6888704	6889060	7403596

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

Shpenzime per menaxhimin e fondit pyjor në lekë

Shpenzime për menaxhimin e fondit pyjor, i llogaritur si vlera vjetore e shpenzimeve të realizuara për menaxhimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e fondit pyjor.

Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka përmirësuar financimin për menaxhimin e fondit pyjor. Shpenzimet janë rritur nga 6,889,060 lekë në vitin 2024 në 7,403,596 lekë në vitin 2025. Kjo rritje tregon një angazhim më të madh financiar për administrimin e fondit pyjor dhe për mbështetjen e ndërhyrjeve që lidhen me mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të këtij fondi.



Në krahasim me vitin 2021, kur shpenzimet ishin 2,829,000 lekë, në vitin 2025 ato janë rritur me 4,574,596 lekë, ose rreth 161.7%, duke treguar një forcim të ndjeshëm të mbështetjes buxhetore për këtë shërbim gjatë periudhës shumëvjeçare.

Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile

Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka rritur ndjeshëm angazhimin financiar për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Shpenzimet për MZSH arritën në 27.7 milionë lekë, nga 18.3 milionë lekë në vitin 2024, me një rritje prej rreth 51%.

Në të njëjtën kohë, numri i rasteve të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit është rritur nga 40 raste në vitin 2024 në 45 raste në vitin 2025, çka tregon një ngarkesë më të lartë pune dhe një shërbim më aktiv në terren.

Performanca është përmirësuar në drejtim të kapaciteteve njerëzore, pasi numri i punonjësve zjarrfikës meshkuj u rrit nga 15 në 16, duke ulur raportin e banorëve për çdo zjarrfikës.



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	**Përshkrim**	**2020**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH	Total shpenzime për MZSH kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë		1,000	1,054	488,563	458,470	**615,904**

Numri i banorëve për zjarrfikës	Raporti i numrit të banorëve ndaj numrit të zjarrfikësve meshkuj (banorë për 1 zjarrfikës M)	1152	1152	832	832	780	

Efiçienca buxhetore në ofrimin e shërbimit MZSH

Total shpenzime për MZSH kundrejt totalit të rasteve të menaxhuara në lekë


Në vitin 2025, treguesi arrin në rreth 615,904 lekë për rast, krahasuar me 458,470 lekë për rast në vitin 2024. Pra, kostoja mesatare për rast është rritur me rreth 34%.

Shërbimi I MZSH ka menaxhuar më shumë raste nw vitin 2025, por me një kosto më të lartë për njësi shërbimi.

Numri i banorëve për zjarrfikës

Raporti i numrit të banorëve ndaj numrit të zjarrfikësve meshkuj (banorë për 1 zjarrfikës M)

Ky tregues ka një përmirësim i dukshëm, pasi në shwrbimin e MZSH ka më shumë personel në raport me popullsinë që mbulon. Për qytetarët, kjo do të thotë potencial më i mirë reagimi dhe shpërndarje më e mirë e ngarkesës së punës brenda shërbimit.



Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.


E dhëna	Njesia matese	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Total shpenzime për mzsh (në lekë)	lekë	12987000	13978000	21046000	15145461	18338814	27715689
Zjarrëfikëse ne dispozicion	numër		2	2	4	3	3
Punonjës të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	numër		87	85			
Numri i stacioneve MSZH	numër		1	1	1	1	1
Numri i punonjesve te MZSH Meshkuj	numër		14	14	15	15	16
Numri total i popullsisë	numër		16124	16124	12483	12483	12483
Raste të menaxhuara për shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit nga MZSH	numër				31	40	45
Koha e daljes nga stacioni (në sekonda) (mesatarja ditën dhe natën)	në sekonda		60	60	60	60	60
Familje të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore të shpërblyera	numër		400	388	3	5	5
Familje të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore të shpërblyera	leke				1,669,854	3,322,484	2,998,717

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

- *Total shpenzime për mzsh (në lekë)*

Nga 12.9 milionë lekë në vitin 2020, shpenzimet arritën në 27.7 milionë lekë në vitin 2025. Krahasuar me vitin 2024, rritja është rreth 9.4 milionë lekë, ose 51%.

Kjo tregon se Bashkia Poliçan i ka dhënë më shumë vëmendje financiare shërbimit të MZSH-së.



Menaxhimi i mbetjeve

Bashkia “Poliçan”, gjatë vitit 2025, për shërbimin Menaxhimi i mbetjeve, ruan të pandryshuar disa elemente kryesore të ofrimit të shërbimit, si frekuenca e grumbullimit 7 ditë në javë, sipërfaqja e mbuluar me shërbim 63 km², sasia totale e mbetjeve të menaxhuara 1,168 ton dhe popullsia e mbuluar me shërbim 8,000 banorë.



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	**Formula e llogaritjes**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Rritja e popullatës së mbuluar me shërbim në zonën rurale	Popullsia rurale e mbuluar / popullsia rurale gjithsej × 100	100.00%	100.00%	99.15%	79.65%	**73.38%**
Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	Popullsia e mbuluar me shërbim / popullsia totale e bashkisë × 100	100.00%	100.00%	100.00%	97.94%	**96.85%**
Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërbimit	Shpenzime totale për shërbimin / sasia totale e mbetjeve	11,558 lekë/ton	12,171 lekë/ton	10,143 lekë/ton	10,143 lekë/ton	**10,143 lekë/ton**
Norma e mbledhjes së tarifës së shërbimit	Të ardhura të arkëtuara nga tarifa / shuma	70.79%	76.70%	86.72%	96.40%	**87.25%**

	totale e faturuar × 100					
Rritja e popullatës së mbuluar me shërbim në zonën urbane	Popullsia urbane e mbuluar / popullsia urbane gjithsej × 100	100.00%	100.00%	82.35%	100.00%	**98.78%**
Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve, mbulimi i kostove nga tarifa	Të ardhurat nga tarifa / shpenzime totale për shërbimin × 100	70.79%	76.70%	86.72%	96.40%	**84.86%**

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

- *Efiçienca buxhetore për ofrimin e shërbimit,*

Raporti ndërmjet shpenzimeve totale për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve dhe sasisë totale të mbetjeve të menaxhuara, në %.

Në vitin 2025, Bashkia Poliçan ka shpenzuar mesatarisht 10,143 lekë për 1 ton mbetje, në të njëjtin nivel me vitin 2024. Kjo tregon se kostoja për njësi të mbetjes së menaxhuar është mbajtur e pandryshuar, pasi edhe shpenzimet totale për shërbimin, edhe sasia totale e mbetjeve të menaxhuara kanë mbetur të njëjta.

- *Rritja e mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve*

Raporti i popullsisë së mbuluar me shërbim ndaj popullsisë totale të bashkisë në %.

Në vitin 2025, mbulimi total me shërbim është 96.85, ndërkohë që numri i popullsisë së mbuluar me shërbim ka mbetur 8,000 banorë.

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njesia matese	2021	2022	2023	2024	2025
Të ardhurat nga tarifa e shërbimit të mbetjeve në lekë	lekë	9557000	10904000	10274000	11420274	10053595
Numri i stafit i angazhuar pr sherbimin	numër	3	3	3	3	4
Numri i përgjithshëm i popullsisë në zonën rurale	numër	3450	3450	3750	4668	4565
Numri i popullsisë në zonën urbane	numër	4550	4550	4250	3500	3695

Sipërfaqja gjithësej e bashkisë	km2	272	272	272	272	272
Shuma totale e faturuar për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	lekë	13500000	14216000	11847000	11847000	11522500
Shpenzime totale për ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mbetjeve	lekë	13500000	14216000	11847000	11847000	11847000
Të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve nga familjet	lekë	200000	486000	335490	323350	247500
Të ardhurat nga tarifat e shërbimit të mbetjeve nga bizneset	lekë	9357000	10415000	14584784	9950401	9806095
Numri i aktiviteteve mjedisore për edukimin e publikut të zhvilluara në vit	numër	8	20	15	15	10
Numri i kontrolleve dhe inspektimeve të mjedisit	numër	20	20	25	25	20
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane (mesatare Q+NjA here ne jave)	ditë në vit	7	7	7	7	7
Sipërfaqe e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në km2	km2	63	63	63	63	63
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në NJA	ton	1.2	1.2	1.2	1.2	1.2
Mbetje të grumbulluara dhe transportuara në qytet	ton	2	2	2	2	2
Siperfaqe e pastruar (ne m2)	m2	33000	33000	33000	33000	33000
Sasia totale e mbetjeve urbane	ton	1168	1168	1168	1168	1168
Numri i popullsisë në bashki e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	8000	8000	8000	8000	8000
Numri i popullsisë në zonen rurale e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve	numër	3450	3450	3718	3718	3350
Numri i popullsisë në zonen urbane e mbuluar me shërbim e menaxhimit të mbetjeve	numër	4550	4550	3500	3500	3650

Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat urbane (ditë në javë)	ditë në javë	7	7	7	7	7
Frekuenca e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve në zonat rurale (ditë në javë)	ditë në javë	7	7	7	7	7

Përkujdesi Social

Bashkia **"Poliçan"**, gjatë vitit **2025**, ka përmirësuar treguesin që lidhet me shpenzimet për ushqimin për fëmijët e shërbyer në qendrat sociale, ndërsa treguesi i përfitimit monetar për PAK ka rënie krahasuar me vitin 2024. Treguesi për furnizimin e çerdheve me materiale didaktike mbetet në nivel të kënaqshëm.



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	**Përshkrimi / formula**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**
Rritja e përfitimit monetar për PAK	Shpenzime totale për mbështetjen e PAK / numri i individëve të mbështetur me aftësi të kufizuara	242,945.76	233,720.63	252,536.09	255,576.35	**233,314.04**
Shërbimi i kujdesit social për familje dhe fëmijë ofrohet	Shpenzime për ushqimin / numri total i fëmijëve të shërbyer në	236,839.00	-	796,250.00	505,573.71	**686,923.71**


sipas standardit kombëtar ligjor	qendrat sociale					
Përmirësimi i mësimdhënies në çerdhe	Çerdhe të furnizuara me material didaktik / numri total i çerdheve × 100	100%	100%	100%	100%	**100%**

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

- *Shërbimi i kujdesit social për familje dhe fëmijë ofrohet sipas standardit kombëtar ligjor*

Raporti ndërmjet shpenzimeve për ushqimin dhe numrit total të fëmijëve të shërbyer në qendrat sociale, i shprehur në lekë për fëmijë.

Në vitin 2025, Bashkia Poliçan ka shpenzuar 4,808,466 lekë për ofrimin e ushqimit, ndërsa numri i fëmijëve të shërbyer në qendrat sociale ka qenë 7 fëmijë. Nga kjo llogaritje rezulton një shpenzim mesatar prej 686,923.71 lekë për fëmijë, krahasuar me 505,573.71 lekë për fëmijë në vitin 2024. Kjo përfaqëson një rritje prej 181,350 lekë për fëmijë, ose rreth 35.9% më shumë se një vit më parë. Përmirësimi tregon rritje të mbështetjes financiare për ofrimin e ushqimit në kuadër të shërbimeve sociale për fëmijët e shërbyer.



- *Përmirësimi i mësimdhënies në çerdhe*

Çerdhe të furnizuara me material didaktik / numri total i çerdheve × 100

Çerdhja është funksionale dhe është furnizuar me materiale mësimore dhe didaktike. Ky është një rezultat pozitiv dhe i qëndrueshëm pwrgjatw vitit 2025.

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njesia matese	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Fëmijë të shërbyer në qendra ditore	numër	6	8	4	7	7	7
Fëmijë të sherbyer gjithsej ne qendrat sociale	numër	6	8	4	7	7	7
Numri total i godinave të kopshteve	numër	9	9	9	9	8	8
Numri i fëmijëve të regjistruar në sistemin parashkollor	numër	157	126	106	99	95	95
Numri i çerdheve dhe kopshteve funksionale	numër	10	10	10	10	9	8
Numri total i godinave të çerdheve	numër	1	1	1	1	1	1
Fëmijë të regjistruar në çerdhe	numër	13	12	13	13	8	10
Edukatore në çerdhe	numër	4	4	4	4	3	3
Shpenzime për ofrimin e ushqimit sipas kategorive të përfituesve (fëmijë sipas grup moshave dhe familje) në qendrat rezidenciale ose ditore(Qendra e te moshuarve)	lekë	1421034		3,185,000	3,539,016	4,808,466	
Shpenzime totale për mbështetjen e pak në lekë	lekë	71669000	73622000	75508291	73605988	69294271	
Viktima të dhunës në familje të asistuar	numër	2	8	4	2	3	1
Numri total i personave PAK që përfitojnë kujdesin social (Pagesë, trajtim në shtëpi, trajtim në qendra PAK)	numër	82	94	11	13	14	13

Numri i qendrave komunitare shumëdisiplinare të përmirësuara / mirëmbajtura në vit	numër	1	1	1	2	3	3
Numri total i personave të moshës së tretë të shërbyer në qendrat sociale rezidenciale	numër	39	40	42	45	41	34
Numri total i personave të moshës së tretë të shërbyer në qendrat sociale ditore	numër	11	15	25	79	81	62
Persona të moshës së tretë të shërbyer në qendrat sociale	numër	11	15	25	79	81	62
Numri i personave PAK të akomoduar në qendrat e shërbimeve sociale	numër	39	40	42	45	41	
Numri i personave të mbështetur me pagesë invaliditeti Femra	numër	84	97	121	114	107	109
Invalidë përfitues nga ndihma sociale	numër	212	230	0	0	0	0
Numri total i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike	numër	192	205	159	140	135	133
Numri i individëve të mbështetur me aftësi të kufizuara	numër	295	315	299	288	297	291
Çerdhe të furnizuara me material mësimor dhe didaktik	numër	1	1	1	1	1	1
Fëmijë pa kujdes prindëror që kanë marrë kujdes nga bashkia	numër	3	3	2	1	1	1

Më poshtë paraqiten të dhënat e treguesit, të shoqëruara me grafikët përkatës.

Strehimi social

Shërbimi konsiston në ofrimin e përfitimeve në natyrë dhe në para për familjet dhe individët në nevojë, me qëllim ndihmën për të përballuar kostot e strehimit dhe për të ulur varfërinë. Ai përfshin ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social sipas ligjit, pagesa të përkohshme ose afatgjata për qiramarrësit, si dhe administrimin e çështjeve dhe shërbimeve të strehimit. Gjithashtu, përfshin promovimin, monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarive për zhvillimin e strehimit dhe ofrimin e mbështetjes financiare për grupet më vulnerabël për të lehtësuar situatat e vështira ekonomike



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	Përshkrim	2021	2022	2023	2024	2025
Rritja e financimit të shërbimit të banesave sociale	Kosto e bashkisë për programin e strehimit social kundrejt numrit total të përfituesve nga (Mije Lekë / përfitues)	345909.09	381866.67			

Të dhënat e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

E dhëna	Njesia matese	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Numri i stafit i angazhuar pr sherbimin	numër	1	2	2	2	2	
Buxheti i bashkisë i alokuar për strehimin social në lekë	lekë	3805000	5728000	0	0	0	
Numri i familjeve përfituese për strehim social	numër	11	15	0	0	0	

Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime

Në vitin 2025, Bashkia “Poliçan” ka ruajtur të pandryshuar mbulimin e popullsisë me shërbimin e ujit të pijshëm, me 10,000 banorë të mbuluar, ose 62.02% të popullsisë totale. Për shërbimin e kanalizimeve, treguesi më pozitiv është rritja e shumës së faturuar, e cila u rrit me 15.1% krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje reflektohet edhe në faturimin për banor dhe në faturimin për km² territor.



Treguesit e shërbimit

Tabela në vijim paraqet të dhënat përkatëse që lidhen me treguesin, duke shënuar vlerat e tij përgjatë viteve të raportimit. Këto të dhëna ofrojnë bazën për të kuptuar më qartë nivelin e performancës së arritur, si dhe për të bërë krahasime ndër vite mbi ecurinë e treguesit në fushën përkatëse.

Treguesi	Formula	2021	2022	2023	2024	2025
Mbulimi i popullsisë me ujë të pijshëm	Popullata që përfiton ujë / popullsia totale × 100	62.02%	62.02%	62.02%	62.02%	**62.02%**
Popullata që përfiton nga shërbimi me ujë të pijshëm	Numri i banorëve të mbuluar	10,000	10,000	10,000	10,000	**10,000**
Rritja e të ardhurave nga faturimi për shërbimin e kanalizimeve	Shuma totale e faturuar	1,732,000	3,357,422	4,235,721	3,625,122	**4,173,449**

Faturimi për banor të mbuluar me ujë	Shuma e faturuar / popullata e mbuluar me ujë	173.2	335.7	423.6	362.5	**417.3 lekë/banor**
Faturimi për km² territor	Shuma e faturuar / sipërfaqja totale e bashkisë	6,368	12,343	15,573	13,328	**15,344 lekë/km²**
Arkëtimi për banor të mbuluar me ujë	Të ardhurat nga tarifa / popullata e mbuluar me ujë	129.9	319.4	307.6	337.8	**336.8 lekë/banor**

Më poshtë do të gjeni treguesit e analizuar, të paraqitur gjithashtu në formë grafike për një kuptim më të lehtë dhe vizual.

Mbulimi i popullsisë me ujë të pijshëm

Raporti ndërmjet popullatës që përfiton nga shërbimi me ujë të pijshëm dhe popullsisë totale të bashkisë, në përqindje.


Bashkia Poliçan, gjatë vitit 2025, ka ruajtur të pandryshuar mbulimin e popullsisë me shërbimin e ujit të pijshëm. Nga 16,125 banorë gjithsej, 10,000 banorë përfitojnë nga shërbimi, duke rezultuar në një mbulim prej 62.02%. Ky tregues nuk shënon rritje krahasuar me vitin 2024, por tregon që bashkia ka ruajtur të njëjtin nivel shërbimi për popullsinë e mbuluar.

Bashkia Poliçan (njësia administrative Poliçan dhe njësia administrative Vërtop) furnizohen me ujë nga burimi i Bogovës.

- Njësia administrative Poliçan furnizohet me ujë 24/7
- Është në përfundim ndërtimi i rrjetit të furrnizimit me ujë 24/7 për fshatrat Mbrakull,Vërtop, Fushë Peshtan, Peshtan, Bregas dhe Vodicë, të njësisë administrative Vërtop.

Rritja e të ardhurave nga faturimi për shërbimin e kanalizimeve

Ndryshimi i shumës totale të faturuar për shërbimin e kanalizimeve nga një vit në tjetrin.



